

20221502015

**LIGJ I GARANCISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT TË
DETYRIMEVE SIPAS MARRËVESHJES SË HUASË PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT TË EMV-SË LIDHUR ME TRANZICIONIN NË FOTOVOLTAIKËT
SOLARË, QË DO TË LIDHET MIDIS BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM DHE SHOQATËS AKSIONARE PËR PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE “ELEKTRANAT E MAQEDONISË SË VERIUT”, NË PRONËSI TË
SHTETIT, SHKUP**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut garanton shlyerjen e detyrimeve dhe përmbushjen e dispozitave të Marrëveshjes së Huasë për financimin e projektit të EMV-së lidhur me tranzicionin në fotovoltaike solarë, që do të lidhet midis Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike “Elektranat e Maqedonisë së Veriut”, në pronësi të shtetit, Shkup, në vlerë prej 25.000.000 EURO, nëse Shoqata Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike “Elektranat e Maqedonisë së Veriut”, në pronësi të shtetit, Shkup nuk i përmbush dhe nuk i servison detyrimet nga Marrëveshja e Huasë.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huasë përcaktohen me Marrëveshjen e Huasë në nenin 1 të këtij ligji, që do të lidhet midis Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike “Elektranat e Maqedonisë së Veriut”, në pronësi të shtetit, Shkup, për financimin e projektit të EMV-së lidhur me tranzicionin në fotovoltaike solarë.

Neni 3

Të gjitha detyrimet financiare që dalin nga Marrëveshja e Huasë në nenin 1 të këtij ligji, si dhe servisimi i huasë, do të kryhen nga Shoqata Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike Elektranat e Maqedonisë së Veriut, në pronësi të shtetit, Shkup, nga të ardhurat e realizuara, në afatet dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 4

Afati për pagesën e huasë nga neni 1 i këtij ligji është 12 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej dy viteve.

Shoqata Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike “Elektranat e Maqedonisë së Veriut”, në pronësi të shtetit, Shkup, do ta kryejë pagesën në 21 këste gjysmëvjetore, që do të mbërrijnë për pagesë më datë 8 mars dhe 8 shtator çdo vit, siç përcaktohet me Marrëveshjen e Huasë në nenin 1 të këtij ligji.

Norma e interesit është variabile dhe përbëhet nga EURIBOR-i gjashtëmujor, i rritur për margjinë fikse prej 1%.

Shoqata Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike “Elektranat e Maqedonisë së Veriut”, në pronësi të shtetit, Shkup, do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, provizion të njëhershëm prej 1% të vlerës së huasë.

Shoqata Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike “Elektranat e Maqedonisë së Veriut”, në pronësi të shtetit, Shkup, do i paguajë BERZH-it provizion për mjetet e patërhequra në vlerë prej 0.5% nga pjesa e patërhequr e huasë në nivel vjetor.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe të detyrimeve reciproke që dalin nga Marrëveshja e Huasë në nenin 1 të këtij ligji dhe Marrëveshja e Garancisë, Ministria e Financave dhe Shoqata Aksionare për Prodhimin e Energjisë Elektrike “Elektranat e Maqedonisë së Veriut”, në pronësi të shtetit, Shkup, do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.